



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E KULTURËS

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, \_\_\_\_\_, 2020

**RAPORT**

mbi dëmtimet e shkakuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019  
në objekte dhe zona të trashëgimisë kulturore

**Përshkrim i përgjithshëm**

Në vijim të tërmetit 6.4 ballë që goditi Shqipërinë, mëngjesin e 26 nëntorit 2019 dhe gjendjes emergjente të shkaktuar si pasojë e shkatërrimeve që pasuan lëkundjet sizmike, Ministria e Kulturës nëpërmjet Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile pranë kësaj ministrie, ka koordinuar menjëherë punën për inspektimin urgjent të gjendjes në objekte dhe zona të trashëgimisë kulturore në territorin e Shqipërisë si dhe në institucionet në varësi të Ministrisë së Kulturës.

Me urdhër të Ministrit të Kulturës nr. 410, datë 9.7.2019 është ngritur dhe funksionon pranë Ministrisë së Kulturës “Komisioni për Planifikimin dhe Përballimin e Emergjencave Civile”, i cili në koordinim dhe bashkëpunim me institucionet në varësi të MK-së ka hartuar planet për përballimin për emergjencat civile. Planet për përballimin e emergjencave civile, kanë për qëllim krijimin e kushteve për të zvogëluar risqet e fatkeqësive në trashëgimi kulturore duke filluar nga parandalimi, përgatitja, përballimi i fatkeqësive dhe rimëkëmbja. Planet përfshijnë masa që duhen marrë nga institucionet e varësisë për zgjidhjen e problematikave të relatuara nga vetë institucionet në kuadër të mbrojtjes nga risqet potenciale nga fatkeqësitë natyrore apo njerëzore. Planet për përballimin e emergjencave parashikojnë procedurën që kryhet në rastin e fatkeqësive, si dhe formën e raportimit.

Grupet teknike për inspektimin e dëmeve nën koordinimin e Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile të Ministrisë së Kulturës janë angazhuar menjëherë duke filluar që nga ora 4:30 e mëngjesit e datës 26 nëntor 2019 e në ditët në vijim për inspektime në pasuritë kulturore si dhe në institucionet e artit, kulturës dhe muzetë nën administrimin e Ministrisë së Kulturës, me qëllim raportimin në kohë reale të situatës dhe vlerësimit të gjendjes në rreth objektet me status monumente kulture (të gjinive dhe tipologjive të ndryshme si banesa/fortifikime/objekte kulturi/vepra inxhinierike etj.), si dhe koleksioneve në të gjithë vendin.

## Table of Contents

Përshkrim i përgjithshëm.....	1
1. Trashëgimia Kulturore – Databaza Ekzistuese .....	3
2. Trashëgimia Kulturore – Vlerësimi i Dëmit.....	5
2.1 Rezultati në bazë të raportimeve .....	6
2.2 Masat e marra .....	8
2.2.1 Informimin e komunitetit për zonat që paraqesin rrezikshmëri .....	8
2.2.2 Mbyllja e muzeve dhe siteve me vizitorë .....	8
2.2.3 Puntelimin/çmontimet /riparimet për zonat që paraqesin rrezikshmëri .....	8
2.2.4 Rilevime/studime/hartim projektsh të vënies në siguri për zonat që paraqesin rrezikshmëri.....	9
2.2.5 Kërkesa për bashkëpunime dhe mbështetje:.....	11
2.2.6 Përgatitja e raportit të detajuar për sektorin e Kulturës në kuadër të PDNA 2020 .....	11
2.2.7 Kërkesë për mbështetje financiare Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Shtetit për Rindërtim .....	13
2.2.8 Kërkesa dhe aplikime për mbështetje financiare nëpërmjet programeve të financimit dhe Donatorë potencialë.....	15
2.2.9 Në kuadër të hartimit të PDNA, Strategjia për rimëkëmbjen e sektorit të kulturës është përgatitur si më poshtë: .....	16

## 1. Trashëgimia Kulturore – Databaza Ekzistuese

Shqipëria mbart një histori të pasur dhe të vazhduar (prej prehistorisë deri më ditët tona) e cila shprehet në nëpërmjet trashëgimisë kulturore materiale, shumëllojshmërisë së shprehive kulturore dhe besimeve fetare. Nënsektori i Trashëgimisë Kulturore në zonën e prekur, është analizuar duke përcaktuar tre kategori kryesore, përkatësisht: Muzetë dhe sitet e trashëgimisë kulturore me biletë hyrje; Monumente dhe zona të trashëgimisë kulturore – Pronësi Publike dhe Private; Koleksione dhe Fonde (që përmbajnë koleksione historike, arkeologjike, etnografike, piktura, si dhe koleksione librash, filmash).

Tabelat në vijim japin të dhënat bazë mbi llojin e trashëgimisë kulturore të prekur dhe institucionet përgjegjëse në zonën e prekur:

TË DHËNA BAZË Trashëgimia Kulturore		
Lloji i Trashëgimisë Kulturore	Institucioni Përgjegjës	Numri (në qarkun Tiranë, Durrës, Lezhë)
<b>Infrastrukturë e trashëgimisë kulturore dhe shërbime</b> - muze, site të trashëgimisë kulturore dhe parqe arkeologjike me tarifë hyrje.	<p><b>Muze:</b> Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë Muzeu Kombëtar i Përgjimeve sekrete "Shtëpia me gjethe", Tiranë Muzeu Arkeologjik, Durrës Muzeu Kombëtar "Gjergj Kastrioti Skënderbeu", Krujë Muzeu Etnografik, Krujë</p> <p><b>Site të Trashëgimisë Kulturore dhe Parqe Arkeologjike:</b> Amfiteatri - Qendra Muzeore, Durrës Kalaja e Lezhës, Park arkeologjik – DRTK Shkodër, IKTK</p>	<p>5 Muze 2 Site arkeologjike</p>
<b>Monumente dhe zona të trashëgimisë kulturore – Pronësi Publike dhe Private</b> (të gjinive dhe tipologjive të ndryshme si fortifikime/site arkeologjike/objekte kulti/vepra inxhinierike/arkitekturë vernakulare etj.)	Ministria e Kulturës; Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore; Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore, Tiranë Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore, Shkodër Qendra Muzeore, Durrës	<p>352 Monumente dhe site 41 zona të mbrojtura</p>

**Koleksione dhe Fonde** Koleksione dhe fonde në muze, biblioteka, arkiva dhe institucione të sistemit të kulturës. Kjo kategori përfshin të gjithë objektet e luajshme pjesë e koleksioneve të veprave të artit, arkeologjike, etnografike, arkivore, libra etj.

Ministria e Kulturës;  
 Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Pasurive Kulturore, Tiranë  
 Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë  
 Muzeu Arkeologjik, Durrës  
 Muzeu Gjergj Kastrioti, Krujë  
 Muzeu Etnografik, Krujë  
 Muzeu i përgjimeve sekrete "Gjethi", Tiranë  
 Galeria Kombëtare e Arteve, Tiranë  
 Qendra Muzeore, Durrës  
 Biblioteka Kombëtare

**54298** objekte të luajshme pjesë e koleksioneve dhe fondeve

Tab. 1 - Kategoritë e analizuar në fushën e Trashëgimisë Kulturore

Të Dhëna Bazë						
Numri i Monumenteve dhe zonave të trashëgimisë kulturore si dhe koleksioneve dhe fondeve të ndara sipas Qarqeve – Tiranë, Durrës, Lezhë						
Qarku	Bashkia	Monument i Kateg. I	Monument i Kateg. II	Monumente Total	Zona të Mbrojtura	Nr. i objekteve / koleksioneve të rregjistruara
Tirana	Tiranë	38	205	243	16	47623
	Kamëz	0	0	0	0	
	Vorë	2	0	2	1	
	Kavajë	8	5	13	1	
	Rrogozhinë	2	0	2	2	
	<b>Tirana Total</b>	<b>50</b>	<b>210</b>	<b>260</b>	<b>20</b>	<b>47623</b>
Durrës	Durrës	28	1	29	7	4222
	Krujë	28	0	28	4	1445
	Shijak	1	0	1	0	
	<b>Durrës Total</b>	<b>57</b>	<b>1</b>	<b>58</b>	<b>11</b>	<b>5667</b>
Lezha	Lezhë	16	1	17	6	1008
	Mirditë	9	2	11	3	
	Kurbin	5	1	6	1	
	<b>Lezha Total</b>	<b>30</b>	<b>4</b>	<b>34</b>	<b>10</b>	<b>1008</b>
<b>Total</b>		<b>137</b>	<b>215</b>	<b>352</b>	<b>41</b>	<b>54298</b>
<b>Gjithë territori në Shqipëri</b>		<b>1284</b>	<b>940</b>	<b>2224</b>	<b>210</b>	<b>92237</b>
<b>Përqindja në raport me gjithë territorin</b>		<b>11%</b>	<b>23%</b>	<b>16%</b>	<b>20%</b>	<b>59%</b>

Tab. 2 - Të dhënat bazë mbi monumentet dhe sitet, zonat e mbrojtura dhe koleksionet e rregjistruara në fushën e Trashëgimisë Kulturore

Në zonën e prekur nga fatkeqësia (qarqet e Durrësit, Tiranës dhe Lezhës) ka gjithsej 54298 objekte të luajtshme - objekte të trashëgimisë kulturore dhe koleksione të regjistruara në bazën e të dhënave kombëtare të pronave të luajtshme kulturore nga të cilat 32,368 objekte të ndodhen në muze dhe depo që administrohen nga Ministria e Kulturës.

Të dhënat bazë për numrin e koleksioneve të regjistruara janë mbledhur nga baza e të dhënave të Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore të Luajtshme. Për shkak të faktit se të gjitha institucionet që administrojnë koleksione janë në proces të regjistrimit të këtyre koleksioneve në bazën e të dhënave kombëtare të Institutit të Regjistrimit të trashëgimisë kulturore të luajtshme, numri i koleksioneve të regjistruara në disa institucione mund të mos pasqyrojë numrin e përgjithshëm real të koleksioneve.

Përmirësimi i teknologjisë me qëllim menaxhimin e qëndrueshëm dhe produkteve dhe shërbimeve cilësore ka qenë një nga prioritetet e Ministrisë së Kulturës gjatë periudhës 2014-2018. Ndërtimi i një baze të dhënash WebGIS për hartografin dhe inventarin e trashëgimisë kulturore dhe siteve, si dhe bazën e të dhënave WebGIS për hartografin e siteve arkeologjike; dixhitalizimi i fondeve të Bibliotekës Kombëtare; janë disa aplikime të teknologjisë në kulturë dhe trashëgimi. Gjithashtu, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Pasurive të Luajtshme kulturore është duke ndërmarrë regjistrimin e të gjitha objekteve të luajtshme në Regjistrin Kombëtar të Pasurive Kulturore "të objekteve të pronave kulturore publike dhe private në Republikën e Shqipërisë", të cilat i nënshtrohen ligjeve shqiptare konventave shtetërore dhe ndërkombëtare. Ky sistem mundëson bashkimin e katalogëve në një bazë të dhënash të vetme, ku objektet e luajtshme identifikohen me kod unik dhe klasifikohen lehtësisht përmes kategorive në disa nivele. Këto inventarë dhe bazat e të dhënave kanë qenë një hap i rëndësishëm në kuadrin e përgatitjes së informacionit fillestar brenda procesit të vlerësimit të dëmit për nënsektorin e trashëgimisë kulturore.

## **2. Trashëgimia Kulturore – Vlerësimi i Dëmit**

Për të patur një pasqyrë të të gjithë situatës në vend nga ana e Ministrisë së Kulturës nëpërmjet Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile, u kërkuar informacion dhe raportim nga të gjitha institucionet e varësisë në territorin e Shqipërisë për objektet dhe zonat e trashëgimisë kulturore që këto institucione kanë nën administrim si dhe për godinat (zyrat) në përdorim nga to.

Në vijim të kërkesës, të gjitha institucionet e specializuara në varësi të Ministrisë së Kulturës (IKTK dhe DRTK), ngritën grupet teknike me përbërje inxhinierë ndërtimi dhe arkitektë të specializuar për ndërtime historike, pjesë e stafit të tyre.

Grupet teknike të ngritura realizuan vlerësim të shpejtë vizual në objekte dhe zona të trashëgimisë kulturore duke i dhënë prioritet zonave ku ishin raportuar dëme dhe atyre në rrezën e lëkundjeve sizmike (sipas kategorisë të monumentit – e parë, e dytë). Puna e grupeve teknike u mbështetet në kohë reale nga zyra me grupin e raportimit i cili merr vlerësimet e grupeve teknike dhe i raporton ato

të përmbledhura në formë tabelare (databazë), duke i prioritizuar vizualisht me ngjyra sipas gjendjes së emergjencës (e kuqe, e verdhë, e gjelbër) si dhe duke paraqitur masat e propozuara.

Për inspektimet u përdor "*Formulari për vlerësimin e dëmtimit në Trashëgimi kulturor*" i hartuar nga ana e Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile në kuadër të Planit për Përballimit të emergjencave civile (*formulari në Aneks 1*). Formulari përmbledh të dhëna mbi identifikimin e monumentit, gjendjen strukturore të tij, dëmin e evidentuar, propozime për masa emergjente, kosto paraprake për masat e propozuara.

Formulari shoqërohet me material fotografik dhe sipas rastit grafik. Formularët e plotësuar nga terreni (grupet teknike) së bashku me materialet fotografike, përcillen në kohë reale në grupin e raportimit i cili plotëson të dhënat në databazë dhe në hartë si dhe ruan materialin fotografik të dërguar si dhe i raporton Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile të Ministrisë së Kulturës.

Për objektet që kanë paraqitur problematika të konsiderueshme (dhe që janë të banuara ose ambiente të vizituara), grupet teknike kanë bashkëpunuar me Institutin e Ndërtimit, Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, Bashkitë respektive etj.

Gjatë periudhës së përballimit të emergjencës u evidentua se kapacitetet njerëzore të institucioneve të sistemit të trashëgimisë kulturore, janë efektive dhe mbulojnë problematikat e detektimit, njoftimit, gadishmërisë në terren në kohë reale. Gjithashtu bashkëpunojnë me grupet operacionale të emergjencave civile në menaxhimin e rasteve të emergjencës. Këto institucione kanë në organikë specialistë për marrjen e masave emergjente përforcuese dhe sinjalizuese në rastet e fatkeqësive, por këto kapacitete duhen fuqizuar për mbulimin e zonave rurale dhe atyre të thella. Gjithsesi në shumicën e institucioneve të trashëgimisë paraqiten një sërë nevojash që kërkojnë mbështetje me burime financiare dhe materiale (pajisje, mjete, transport etj.)

### *2.1 Rezultati në bazë të raportimeve*

Në periudhën 26 nëntor 2019 – 12 janar 2020, janë realizuar inspektime në qarqet Durrës, Tiranë (DRKK Durrës dhe IMK), Shkodër, Lezhë, Dibër, Kukës (DRKK Shkodër), Berat (DRKK Berat), Korçë (DRKK Korçë), Vlorë (DRKK Vlorë), Gjirokastrë (DRKK Gjirokastrë).

Zona e administruar nga DRKK Durrës dhe DRKK Shkodër (Qarqet Durrës, Lezhë, Tiranë, përkatësisht Bashkitë Durrës, Krujë, Prezë, Lezhë, Tiranë) rezultojnë si zonat më të prekura nga tërmeti.

Bashkëlidhur këtij raporti gjendet, tabela përmbledhëse me objektet e Trashëgimisë Kulturore dhe godinat institucionale në varësi të Ministrisë së Kulturës të inspektuara si dhe klasifikimi i tyre sipas dëmtimit (*Aneks 2*).

Në vijim të inspektimeve raportohen gjithsej në të gjithë territorin 260 objekte të inspektuara, nga të cilat 111 objekte në zonën më të prekur nga tërmeti, klasifikimi i përgjithshëm i të cilave është paraqitur në tabelën e mëposhtme<sup>1</sup>:

GRADA E DËMTIMIT	NUMRI I MONUMENTEVE KULTURORE
<b>Grada III - Risk i lartë (i papërdorshëm)</b>	<b>23</b>
<b>Grada II - Pjesërisht i përdorshëm</b>	<b>30</b>
<b>Grada I - Pa rrezik</b>	<b>48</b>
Ndërtime të dëmtuara para tërmetit	9
Nr. Total i monumenteve / siteve / institucioneve të inspektuara në zonat e prekura nga tërmeti	<b>111</b>
Përqindje e monumenteve të inspektuara Nr. i inspektimeve (111) / Nr. total i monumenteve në zonat e prekura (352) – i referohet të dhënave bazë më sipër.	<b>32%</b>

*Tab. 3 - Tabela përmbledhëse që tregon gradën e riskut në objektet me status monument kulture/ site / institucione në varësi të MK-së*

### **Zonat ku nuk raportohen dëme**

Raportimet për zonat në rrezen dytësore të tërmetit – ku nuk janë raportuar dëme, kanë ardhur në bazë qarqesh nëpërmjet Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore përkatëse si më poshtë:

<b>Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK) Gjirokastrë</b>	nuk raportohen dëme në trashëgimi kulturore.
<b>Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK) Vlorë</b>	nuk raportohen dëme në trashëgimi kulturore.
<b>Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK) Korçë</b>	nuk raportohen dëme në trashëgimi kulturore.
<b>ZAKPA Apolloni, Bylis, Butrint</b>	nuk raportohen dëme në trashëgimi kulturore.

<sup>1</sup> Tabela përmbledhëse në këtë raport si dhe ajo e detajuar në Aneks 2 paraqet numrin e objekteve të inspektuara deri në datën 12 janar 2020. Tabela është në përditësim të vazhdueshëm, inspektimet parashikohet të vazhdojnë si pjesë e punës vjetore të DRTK-ve. Në përfundim të inspektimeve, numri i objekteve të dëmtuara mund të jetë më i lartë dhe do të reflektohet në hartën e riskut që përditësohet cdo vit nga IKTK.

## 2.2 Masat e marra

Nga ana e Ministrisë së Kulturës dhe institucioneve të saj të varësisë janë marrë masat për:

### 2.2.1 Informimin e komunitetit për zonat që paraqesin rrezikshmëri

- Bashkëpunim me njësitë vendore, për vendosjen e perimetrave të sigurisë si dhe është ndaluar kalimi i këmbësorëve dhe automjeteve pranë zonave dhe objekteve të rrezikuara si në rastin e Kalasë së Krujës, Kalasë së Prezës dhe Kullës C në Kalanë e Durrësit, Muzeut Historik Kombëtar etj.
- Nga ana e DRTK Tiranë janë marrë masat dhe janë vendosur tabela parandaluese në monumentet që paraqesin rrezikshmëri për kalimtarët.
- Në vijim të rrezikut potencial për shpëputjen e masivit shkëmbor poshtë Kullës së Sahatit në Kalanë e Krujës, nga ana e IKTK-së i është kërkuar Bashkisë Krujë të marrë masat për evakuimin e të gjithë banorëve dhe bizneseve që ndodhen në zonën e rrezikuar deri në raportimin më të detajuar të situatës nga ana e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dhe nga forcat e Xhenjos së ushtrisë.
- DRTK Shkodër ka bashkëpunuar gjithashtu me njësitë vendore dhe prefekturën për marrjen e masave për informimin e komunitetit dhe vendosjen e perimetrave të sigurisë.

### 2.2.2 Mbyllja e muzeve dhe siteve me vizitorë

- Nga ana e Ministrisë së Kulturës u dha direktivë të gjitha muzeve dhe siteve me vizitorë të qëndrojnë të mbyllura për vizitorët deri në marrjen e akt konstatimit nga Instituti i Ndërtimit (IN) që objekti nuk paraqet rrezikshmëri. Gjithsesi puna e stafit të këtyre muzeve nuk u ndërpre në asnjë moment dhe të gjithë ishin në gadishmëri.
- Pas marrjes të akt konstatimeve muzetë dhe sitet që nuk paraqesnin rrezikshmëri vijuan punën, ndërsa dy Muzetë – Muzeu Historik Kombëtar dhe Muzeu Kombëtar Shtëpia me Gjethe, janë ende të mbyllur deri në përpilimin e akteve të ekspertizës së detajuara nga ana e IN apo marrjen e masave për riparime / restaurime.

### 2.2.3 Puntelimin / çmontimet / riparimet për zonat që paraqesin rrezikshmëri


- DRTK Tiranë kanë marrë masat për riparimin e çatisë së kishës në kepin e Rodonit.
- Në bashkëpunim me stafet teknike të mirëmbajtjes të DRTK-ve Berat, Vlorë, etj. janë marrë masat për puntelim në kullën verilindore në Kalanë e Prezës si dhe çmontim pjesor të disa prej strukturave të rrezikuara për rënie në murin e Kalasë së Krujës.
- Nga ana e IKTK-së janë marrë masa për grumbullimin e pjesëve të rëna të afreskut në Teqenë e Dollmës (për rikuperim në kushte laboratorike) me qëllim pastrimin e terrenit të brendshëm për puntelimin e strukturës dhe pjesët e afreskut janë kataloguar dhe dërguar në laboratorin e IKTK.



- Në objektin e Teatrit të Kukullave në datën 27.11.2019, u realizua çmontimi i oxhakëve në çatinë e teatrit të cilët ishin dëmtuar dhe rrezikonin shembjen rrjedhimisht dëmtimin e mundshëm të kalimtarëve.
- Më dt. 29.11.2019, në Fakultetin e Gjeologji Miniera janë marrë masat për çmontimin e ballkonit i cili rrezikonte shembjen – Administrata e Fakultetit nëpërmjet Firmës “Fusha”.
- DRKK Berat ka marrë masat për çmontim të tavanit të dëmtuar (që rrezikon shembjen) në Banesën e familjes Kondakçiu, monument kulture kategori e dytë.
- Në vijim të problematikës së banesave që janë të braktisura dhe paraqesin rrezik për kalimtarët apo të banesave të tjera pranë, DRTK-Berat ka marrë masat për njoftimin e qytetarëve të evitojnë kalimin në atë zonë dhe hartimin e projektit të ndërhyrjes. Specialistët e mirëmbajtjes DRTK-së Berat kanë restauruar murin rrethues të oborrit të dëmtuar të një banese i cili rrezikon jetën e kalimtarëve.

#### **2.2.4 Rilevime/studime/hartim projektesh të vënies në siguri për zonat që paraqesin rrezikshmëri**

- DRTK Tiranë në bashkëpunim me specialistë nga Kosova ka realizuar rilevimin 3D me dron të kalasë së Krujës dhe atë të Prezës (datë 30.11.2019).
- Nga ana e MK-së dhe IKTK-së janë marrë masa për angazhimin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar në vlerësimin e qëndrueshmërisë së terrenit shkëmbor poshtë Kullës së Sahatit të Krujës që paraqet rrezikshmëri për shkak të masivit dhe është hartuar raporti gjeologjik për kalanë e Krujës nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar.
- IKTK ka hartuar projektet e stabilizimit emergjent për Kullën e Sahatit Prezë, Kullën e Vrojtimit Krujë, Teqen e Dollmës Krujë, Muret perimetrale të kalasë së Prezës dhe Krujës, Muzeun Historik Kombëtar, Galerinë Kombëtare të Arteve të cilat janë miratuar në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM).
- CHwB në bashkëpunim me IKTK ka hartuar projektin për stabilizim emergjent në kalanë e Durrësit (Kulla C).
- IKTK është gjithashtu duke hartuar projektet e restaurimit të një sërë objektesh të klasifikuara nga inspektimet si Grada II-pjesërisht të përdorshëm dhe Grada III-risk i lartë.
- DRTK Berat duke hartuar projektin dhe përpunimin e materialit grafik që do e paraqesë për miratim në KKTKM, duke e propozuar në ndërhyrjet e fillim viti për kishën e Shën Joan Gojëartit ku janë raportuar avancime të degradimeve në pjesën e çatisë dhe kuotës së sipërme të muraturës.
- DRTK Berat ka hartuar projektin e restaurimit të banesës së familjes Goxhomane e cila u inspektua gjatë datës 28.11.2019, ku më urgjente është çatia e cila ka probleme konstruktive. Situata është po e njëjtë dhe paraqet rrezikshëri. DRTK ka projekt të miratuar dhe do të hartojë së shpejti planin e ndërhyrjes në fillim të këtij viti.
- IKTK ka realizuar në hartën (mapping) nw formatin GIS të monumenteve të inspektuara për zonat më të prekura. Objektet paraqiten sipas gradave të dëmtimit figura më poshtë. Kjo hartë është subjekt përditësimi hap pas hapi me mbledhjen e informacionit nga inspektimet.



Tab. 4 - Harta që tregon monumentet e trashëgimisë kulturore të rrezikuara

## 2.2.5 Kërkesa për bashkëpunime dhe mbështetje

- Kërkesë e drejtuar nga Ministri i Kulturës kundrejt homologëve të tij në rajon dhe Evropë, si dhe përfaqësuesve diplomatikë të këtyre shteteve në Shqipëri – Ambasadave, për mbështetje dhe bashkëpunim. **(Check Listën e ambasadave dhe ministrave ku është bërë kërkesa)**
- Në përgjigje të kërkesave për bashkëpunim, grupe të ndryshme teknike nga rajoni dhe Evropa janë angazhuar për të kontribuar në vlerësimin e dëmit dhe dhënies së rekomandimeve për grupet teknike të sistemit të trashëgimisë. Disa nga grupet teknike dhe shtete që janë përgjigjur janë: Ambasada Italiane ka bërë të mundur angazhimin e grupeve teknike operative italiane; Ambasada Hungareze ka bërë të mundur angazhimin e grupeve teknike të specializuara në trashëgimi kulturor në rrezik; Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor. **(këto në dijeninë tonë, të shtohen të tjera nëse ka)**

## 2.2.6 Përgatitja e raportit të detajuar për sektorin e Kulturës në kuadër të PDNA 2020

- Ministria e Kulturës u përfaqësua nëpërmjet IKTK-së në përgatitjen e raportit të detajuar në kuadër të PDNA- post disaster need assessment, e cila u koordinua nga grupi i Komitetit ndërmintor për emergjencat civile me sekretariat nga Kryeministria. Në raport u përfshinë dhe nevojat dhe vlerësimi në trashëgimi kulturor. Raporti përfundimtar për dëmin dhe nevojat kombëtare u hartua në bashkëpunim nga të gjithë sektorët dhe nën koordinimin e institucioneve ndërkombëtare si UN, UNDP, World Bank, EU, UNICEF, UNESCO etj. Në këtë proces IKTK është në koordinim të vazhdueshëm me organizatat ndërkombëtare që kanë programe për planifikimin dhe përballimin e riskut në trashëgimi kulturor si UNESCO, ICOMOS dhe ICCROM. Në koordinim me këto organizata IKTK organizoi punën teknike në përputhje me standartet ndërkombëtare për vlerësimin e dëmit dhe masat emergjente për stabilizimin strukturor.
- *Vlerësimi i humbjeve* në tre kategoritë e analizuar sa më sipër është llogaritur duke marrë parasysh humbjet e të ardhurave për shkak të uljes të numrit të vizitorëve, mbylljen e muzeve dhe anulimin e eventeve (qiratë, ekspozitat etj). Gjithashtu masat e ndihmës së parë si puntelimet/pajantimet në disa struktura të rrezikuara (si në kullën e fortifikimit të Prezës), kostot e heqjes së mbetjeve inerteve, çmontimi i strukturave të dëmtuara që ishin rrezik për mjedisin dhe kalimtarët, si dhe zbatimin e sinjalistikës së nevojshme, siç është perimetri i sigurisë dhe tabelat për zonat me rrezik. Rreziqet të mëtejshme dhe vulnerabiliteti me të cilat përballen strukturat dhe koleksionet janë konsideruar gjithashtu në pjesën e humbjeve (p.sh. jo i shembur por gjendje shumë e dëmtuar e mureve si p.sh. në kështjellën e Lezhës dhe kështjellën e Bashtovës)
- *Vlerësimi i Dëmit* është realizuar në vlerësim me bazë objekti të ndara në pronësi publike dhe private.

Më poshtë tabelat përmbledhëse të vlerësimit të humbjeve dhe dëmit të ndara sipas kategorive dhe bashkive:

Sektori - Trashëgimi Kulturorë Kategoritë e analizuarë	Dëmi (në milion Lekë)		Humbja (në milion Lekë)		Total (në milion Lekë)	
	Vlera e përlogaritur		Vlera e përlogaritur		Vlera e përlogaritur	
	Privat	Publik	Privat	Publik	Privat	Publik
1. Muze dhe site me tarifë hyrje		31.09		21.14	-	52.24
2. Monumente Kulture dhe site	119.31	501.88	0.25	33.05	119.56	534.93
3. Koleksione dhe fonde		0.86		-	-	0.86
<b>TOTAL Lekë</b>	<b>119.31</b>	<b>533.82</b>	<b>0.25</b>	<b>54.19</b>	<b>119.56</b>	<b>588.02</b>
<b>TOTAL EURO</b> 1€ = 123.05 ALL	<b>0.97</b>	<b>4.34</b>	<b>0.002</b>	<b>0.44</b>	<b>0.97</b>	<b>4.78</b>

Në total në vlera e përlogaritur e efektit të tërmetit (humbje dhe dëm) në trashëgimi kulturorë është **707.58 milion lekë** ose 5.75 milion euro.

Trashëgimia Kulturorë dëmi dhe humbja						
Bashkitë	Efekti i fatkeqësisë (në miliona)					
	Dëmi në Lekë	Dëmi në Euro	Humbja në Lekë	Humbja në Euro	Totali në Lekë	Totali në Euro
Durrës	66.94	0.54	7.41	0.06	74.35	0.60
Shijak	-	-	-	-	-	-
Krujë	297.97	2.42	14.89	0.12	312.86	2.54
Lezhë	7.80	0.06	9.05	0.07	16.85	0.14
Mirditë	7.40	0.06	0.20	0.002	7.60	0.06
Kurbin	0.86	0.01	0.35	0.003	1.21	0.01
Tiranë	243.76	1.98	11.04	0.09	254.81	2.07
Kamëz	-	-	-	-	-	-
Vorë	15.40	0.13	1.50	0.01	16.90	0.14
Kavajë	5.00	0.04	1.00	0.01	6.00	0.05
Rrogozhinë	8.00	0.07	9.00	0.07	17.00	0.14
<b>Vlera e Efektit</b>	<b>653.14</b>	<b>5.31</b>	<b>54.44</b>	<b>0.44</b>	<b>707.58</b>	<b>5.75</b>

## 2.2.7 Kërkesë për mbështetje financiare Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Shtetit për Rindërtim

Nga ana e MK-së është drejtuar kërkesë për fonde në lidhje me nevojën për rimëkëmbje (restaurim / rikonstrukcion) dhe fond për vlerësimin/studimin/projektimin e objekteve më me prioritet për t'u restauruar në zonën e prekur nga tërmeti.

Nr.		Qyteti	Emertimi i objektit	Total nevoja per rimekembje	Projekti i miratuar/ Vlera e projektit te emergjences	Vleresimi/ studimi/ projektimi
1	Muze dhe site të trashëgimisë kulturore, në të cilat paguhet tarifë hyrje	Tiranë	Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë,	22,200,000	2,632,571	1,554,000
2			Muzeu Kombëtar i Përgjimeve sekrete "Shtëpia me gjethe", Tiranë	10,000,000	2,343,891	700,000
3		Durrës	Muzeu Arkeologjik, Durrës	4,800,000	-	336,000
4			Amfiteatri, Durrës	5,200,000	-	364,000
5		Lezhë	Kalaja e Lezhës - Park arkeologjik	15,000,000	-	1,050,000
6	Pronësi Publike - Monumente dhe site të trashëgimisë kulturore	Tiranë	Kalaja e Prezës (Kulla e Sahatit dhe Kulla verilindore) Prezë	20,000,000	1,195,978	1,400,000
7			Kalaja e Bashtovës, Rrogzhinë	30,000,000	20,900,000	2,100,000
8			Teatri i Kukullave, Tiranë	30,000,000	9,818,251	2,100,000
9			Akademia Kombëtare e Shkencave, Tiranë	16,000,000	3,712,745	1,120,000
10			Godina e Ish Kinostudios, Ministria e Kulturës, Tiranë	5,000,000	761,432	350,000
11			Godina e "Vettingut" (Ish Lidhja e Shkrimtarëve), Tiranë	4,000,000	496,378	280,000
12			Galeria Kombëtare e Arteve, Tiranë	29,000,000	-	2,030,000
13			Biblioteka Kombëtare - Tiranë	46,000,000	-	3,220,000
14			Biblioteka Kombëtare "Fondi"- Tiranë	10,000,000	-	700,000
15			Banesa e "Arkaxhijve" - Muzeu Etnografik Kavajë	8,000,000	-	560,000
16			Durrës	Kalaja e Durrësit (Kulla C dhe muret e fortifikimit)	30,000,000	2,234,100
17		Porto Romano, Durrës		2,000,000	-	140,000

18			Kalaja e Ishmit dhe banesa pranë mureve të kalasë, Durrës	3,600,000	–	252,000	
19			Kalaja e Rodonit dhe Kisha e Shna Ndout në Kepin e Rodonit, Durrës	1,800,000	–	126,000	
20			Kalaja e Krujës (Kulla e Sahatit dhe muret e fortifikimit), Krujë	290,000,000	7,682,930	20,300,000	
21			Teqeja e Dollmës (në Kalanë e Krujës)	21,500,000	208,764	1,505,000	
22			Hamami në oborrin e Shkollës "16 Shtatori", Durrës	6,000,000	–	420,000	
23			Ura e Kurcajt në përroin e Zorzës, Krujë	5,500,000	4,371,448	385,000	
24			Banesa e "A Moisiu"- Muzeu Etnografik, Durrës	8,500,000	–	595,000	
25		Lezhë		Rrënojat e Kishës së Shën Mërisë, Mamurras, Kurbin	900,000	–	63,000
26				Kisha e Manastirit të Rubikut, Mirditë	400,000	–	28,000
27				Banesa e Mlikajve, Muzeu Etnografik, Lezhë	7,000,000	–	490,000
28		Tiranë		Banesa e Sulejman Kullës, Gjuricaj, Durrës	15,500,000	–	1,085,000
29				Banesa e Sali Shijakut, Tiranë	3,100,000	2,565,297	217,000
30				Banesa e Muharem Hoxhës, Ranxë, Tiranë	15,000,000	–	1,050,000
31				Banesa e Ahmet Çunit, Murrizë, Tiranë	8,000,000	–	560,000
32			Banesa e familjes "Kazani", Tiranë	3,600,000	–	252,000	
33			Godina e Ish të përndjekurve politikë, Tiranë	13,000,000	–	910,000	
34	Lezhë		Banesa e Preng Lleshit, Mashtërkore, Mirditë	8,500,000	–	595,000	
35			Ish Arqipeshkëvia e Durrësit në Delbnisht, Kurbin, Lezhë	500,000	–	35,000	
			<b>Shuma totale</b>	<b>699,600,000</b>	<b>58,923,785</b>	<b>48,972,000</b>	

Check listen dhe vlerat e derguara ministrise se Finances nga MK.

## 2.2.8 Kërkesa dhe aplikime për mbështetje financiare nëpërmjet programeve të financimit dhe Donatorë potencialë

CHwB në bashkëpunim dhe me mbështetjen e IKTK-së ka aplikuar për mbështetje financiare tek Fondi i Ambasadorit pranë Ambasadës Amerikane. Fondi parashikon konsolidimin strukturor dhe restaurimin e objekteve të klasifikuara si objektet më të dëmtuara nga fatkeqësia si më poshtë:

Emri i Monumentit	Kosto paraprake në USD (\$)
Teqja e Dollmës, Kalaja Krujë	19.000 \$
Faza I- Stabilizim emergjent	105.000 \$
Faza II – Restaurim i plotë	
<hr/>	
Kulla e Sahatit në kalanë e Krujës (pa përfshirë përforcimin e shkëmbit poshtë saj)	
Faza I- Stabilizim emergjent i Kullës	80.000 \$
Faza II – Restaurim i plotë i kullës dhe mureve të kalasë së Krujës	310.000 \$
<hr/>	
Kalaja e Prezës - kulla e sahatit dhe kulla verilindore e kalasë	12.000 \$
Faza I- Stabilizim emergjent	140.000 \$
Faza II – Restaurim i plotë	
<hr/>	
Kalaja e Durrësit – Kulla C dhe muri midis kullës A dhe B – Hartuar CHwB	
Faza I – Stabilizim emergjent	
Faza II – Stabilizim pas emergjencës, rilevim, projektim	27.600 \$
Faza III – Zbatim punimesh restaurimi	51.000 \$
	242.000 \$

Nga fondi i Ambasadorit pritet fondi për restaurimin e plotë, ndërkohë për punimet për stabilizim emergjent (sipas projekteve të hartuara nga IKTK dhe CHwB), CHwB në bashkëpunim me IKTK-në janë në proces aplikimi për mbështetje financiare nga Prince Claus Fund.

**Marrëveshja e lidhur midis MK-së dhe subjektit privat që do financojë studimin dhe hartimin e projektit të stabilizimit të shkëmbit dhe terrenit në Krujë. Check**

Nëpërmjet UNESCO, do të llobohet në konferencën e Donatorëve (17 shkurt 2020), për financimin e prioriteteve si më poshtë:

- Kalaja e Krujës
- Teqja e Dollmës
- Kalaja e Durrësit
- Kalaja e Prezës
- Kalaja e Bashtovës
- Muzeu Etnografik “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Këto prioritete janë përcaktuar nga Ministri i Kulturës.

## 2.2.9 Në kuadër të hartimit të PDNA, është përgatitur Strategjia për rimëkëmbjen e sektorit të Kulturës

Nevoja për Rimëkëmbje	Strategjia për Rimëkëmbje - Plan Pune (në milion Lekë)			
	Afat shkurtër 2020/21	Afat mesëm 2021/23	Afat gjatë 2023/25	Totali
Restaurimi / Rindërtimi i Monumenteve të dëmtuara	36.45	239.34	379.24	655.03
Vlerësime dhe studime të detajuara	27.62			27.62
Masa Emergjente	20.72			20.72
Riparim i pajisjeve të dëmtuara	3.00			3.00
Pajisje (për monitorim dhe vlerësim të shpejtë dëmi)	4.80			4.80
Masa për reduktimin e risqeve nga fatkeqësitë - DRR		79.54	22.77	102.31
Programe për ngritjen / forcimin e kapaciteteve profesionale (trajnime etj)		22.10	22.70	44.80
Programe për rritjen e ndërgjegjësimit			35.00	35.00
Hartimi i Planeve të Menaxhimit të Riskut për pasuritë kulturore			3.40	3.40
Përmirësimi i normave teknike të projektimit në fushën e restaurimit			10.00	10.00
<b>TOTALI në milion Lekë</b>	<b>92.59</b>	<b>340.99</b>	<b>473.10</b>	<b>906.68</b>
<b>Totali në milion Euro 1€ = 123.05 ALL</b>	<b>0.75</b>	<b>2.77</b>	<b>3.84</b>	<b>7.37</b>



**Bashkëlidhur:**

Aneks 1 – Formulari për vlerësimin e dëmtimit në Trashëgimi kulturore

Aneks 2 – Databaza mbi gjendjen e objekteve dhe zonave të trashëgimisë kulturore kulturore

Duke ju falënderuar,